



**Prontapresa** është një produkt hidraulik special, i cili ndryshe nga produktet e tjera konkurrenre, ka ngjyrë gri e ngjashme kjo me ngjyrën e betonit, i cili eliminon njollat jo-estetike mbi sipërfaqet e riparuar. Formula e saj e re, në sajë të studimeve të kryera nga qendra kërkimore Buzzi Unicem, ruan në mënyrë të përsosur rezistencën mekanike ku dominon rezistenca afatgjatë. Ky produkt shërben në përgjithësi për të kryer riparime të shpejta si vulosje të boshllëqeve apo rregullime të pllakave. Ka një rezistencë të lartë mekanike ndaj presionit atmosferik si në stinë të shkurta (3 Mega Paskal në 10 minuta, 10 Mega Paskal në orë) ashtu edhe të gjata (> 45 Mega Paskal e 28 ditë). Për më tepër, elementët përbërës të saj janë të padepërtueshme nga lagështira dhe nuk bymehen.

## Buzzi Unicem

### Prontapresa Lidhës hidraulik i posaçëm për rezultate të menjëhershëm

#### Karakteristikat

Përzierja Prontapresa prezantohet si një zgjidhje që ofron shpejtësi në përdorim dhe lehtësi në rezultate: efekti i saj është i dukshëm që prej 2-3 minutave të para të përdorimit, dhe vetëm 5 minuta pas përzierjes me ujë jep rezultatet përfundimtare ku dominon rezistenca e shkëlqyer.

Menjëherë pas përzierjes së parë, produkti merr formë të ngjashme me përzierjet e çimentos Portland e në vijim rritet gradualisht fortësia dhe rezistenca. Ndryshe nga shumë produkte të tjera të tregut, Prontapresa nuk shfaq asnjë reduktim të rezistencës e qëndrueshmërisë me kalimin e kohës.

#### Vlerat e përfutuara në laborator në temperaturë prej 20°C

##### Kohëzgjatja [Uni-EN 196 / 3]

Filimi	2 minuta
Përfundimi	3 minuta

##### Rezistenca ndaj presionit [Uni-EN 196 / 1]

Koha	Maturimit të rezistencës
10 minuta	3 MPA
1 orë	10 MPA
24 orë	20 MPA
7 ditë	35 MPA
28 ditë	50 MPA

#### Fushat e përdorimit

Prontapresa është një produkt i gatshëm për përdorim i cili shërben për:

- Riparimin e pllakave, kangjellave, tubave, produkteve hidrosanitare, radiatorëve etj.
- Riparon çdo panel, kuti dhe instalim elektrik.
- Vulos, riparon dhe krijon me shpejtësi qoshet.
- Shërben për kryerjen e meretimeve të suvatimeve në sipërfaqet horizontale.
- Bllokon infiltrime apo rrjedhje të ujit.
- Vulos çarje në sipërfaqe të çimentuara, çisterna etj.
- Riparon dritare dhe veshje të sipërfaqeve vertikale (mureve).
- Përparësia kryesore e tij është përshpejtimi i shfaqjes së rezultateve si dhe koha që nevojitet për përdorim.

#### Mënyra e përdorimit

##### Dozologjia dhe instruksione të paketimit

Për çdo qese (prej 25 kg) nevojiten 5,3 - 5,7 litra ujë i pastër. Në mënyrë që të keni rezultatet e dëshiruara të një migme mjaft plastike, përdorni vetëm sasinë e ujit që nevojitet sipas instruksioneve të mësipërme.

Përzierjen me shpejtësi në mënyrë manuale ose me përzierësin mekanik. Mos tejkaloni kohën e përcaktuar sepse rezultatet janë mëse të dukshme që në momentin e parë të përzierjes. Në stinë e verës përdorni ujë të freskët, ndërsa në stinë e

## Prontapresa

Lidhës hidraulik i posaçëm për rezultate të menjëhershëm

## Produkte Speciale

dimrit nëse është e mundur ujë të ngrohtë.

Kontenieri dhe çdo pajisje tjetër që do të përdorni duhet të jenë të pastër nga mbeturina të mundshme; pastroni me kujdes çdo pajisje menjëherë pas përdorimit dhe pas çdo pushimi gjatë punës.

### Parapregatitja e sipërfaqes së përdorimit

Sipërfaqet në të cilat do të përdoret ky produkt duhet të jenë paraprakisht kompakte, të pastruara mirë dhe të thata. Përpara përdorimit sigurohuni që sipërfaqja të jetë pastruar nga pluhuri dhe nga çdo mbeturinë e mundshme.

Në rast se sipërfaqja ku do të përdoret produkti është shumë e lëmuar, atëherë ashpërsojeni pak duke e limuar, lageni me ujë dhe lëreni të thahet plotësisht, veëanërisht nëse sipërfaqja është e ekspozuar ndaj diellit.

### Përdorimi

Aplikoni përzjerjen me një mistri apo shpatull vertikalisht brenda kohës së nevojshme. Në rast të një trashë të lartë, përdorni përzjerjen në sipërfaqen pasardhëse dhe prisni forcimin e saj deri në aplikimin e shtresës së dytë.

Pas aplikimit të përzjerjes, sipërfaqja duhet të nivelohet menjëherë në mënyrë që përhapja e produktit mbi të të jetë uniforme si në gjendjen e mëparshme.

Ngrirja fillestare e përzjerjes së produktit mund të ngadalësohet duke shtuar pak çimento Portland (10 – 20% të përzjerjes totale). Në këtë rast shtoni pak më tepër sasinë e ujit të rekomanduar më

lart me qëllim që të keni rezultatet e dëshiruara. Produkti mund të përzjehet me çdo lloj çimento Portland dhe në varësi të sasisë së përdorur kjo ndihmon përshejtimin apo ngadalësimin e kohës së trashjes së përzjerjes.

### KINI KUJDES!

Sjellja e produktit në gjendjen e mëparshme është e mundur edhe gjatë kohës së trashjes, por në këtë rast nuk garantoen rezultate përfundimtare të kënaqshme.

Ashtu si të gjitha produktet me bazë çimento, produkti nuk duhet të përzjehet me allçi ose materiale të tjera me bazë allçinë me qëllim parandalimin e bymimit që çon në fryrje.

Ruajeni produktin të mbyllur në ambjent pa lagështirë.

Në rast se nuk përdorni të gjithë produktin, pjesën e mbetur ruajeni në qesen e saj origjinale të mbyllur në një qese të dytë plastike të mbyllur mirë në mënyrë që të ruhet nga lagështira. Bazuar në D.M. 10/04/2005 të treguar dhe në paketimin përkatës.

---

**Shënim:** Konsideroni instruksionet e lartpërmendura, të cilat janë fryt i eksperiencës sonë më të mirë, si indikative. Në nuk do të jemi përgjegjës për dëme apo difekte të shkaktuara nga keqpërdorimi i produkteve apo në rast të mosrespektimit të kërkesave për sipërfaqet ku do të përdoret produkti. Sidoqoftë, shërbimi i ndihmës teknike është gjithmonë në dispozicionin tuaj dhe ju ofron këshilla në lidhje me mënyrën e përdorimit dhe kryerjen e provave paraprake.

---

### Buzzi Unicem S.r.l.

via Luigi Buzzi, 6  
15033 Casale Monferrato [AL]  
Italia  
tel +39 0142 416219  
fax +39 0142 416320  
info@buzziunicem.it  
www.buzziunicem.it